Procesverbal 03/2020

I mbajtur me datën 01.04.2020 në mbledhjen e III të rregullt të Komitetit për Komunitete, e udhëhequr nga z.Hajriz Haziri.
Mbledhja filloi në ora11,00 h.

Kryesuesi Komitetit për Komuniteteve z. Hajriz Haziri – I përshëndeti të gjithë të pranishmit duke ju dëshiruar punë të mbarë dhe e propozoi këto pika të rendi të ditës:

1. **Konfirmimi i pjesëmarrësve në mbledhjen e KK-ve;**
2. **Miratimi i rendit të ditës;**
3. **Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;**
4. **Mbështetje e luftës kundër pandemisë COVID-19.**
5. **Të ndryshme.**

Pika: 1
Kryesuesi Komitetit për Komuniteteve z. Hajriz Haziri - Fillimisht e konfirmoi pjesëmarrjen e anëtarëve të KK-ve. Mungoi znj.Zorica Kostic me leje. Prezent ishte edhe nënkryetari i komunës z. Florim Bajrami.

Pika: 2
Miratimi i rendit të ditës:
Miratohet rendi i ditës nga të gjithë anëtarët pjesëmarrës.

Pika: 3
Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar:
Miratohet procesverbali i mbledhjes së kaluar pa vërejtje .

Pika: 4
Mbështetje e luftës kundër pandemisë COVID-19.

Kryesuesi Komitetit për Komuniteteve z. Hajriz Haziri- Fillimisht i përshëndeti të pranishmit njëkohësisht i njoftoi më shumë rreth gjendjes aktuale ekonomike dhe sociale të komuniteteve në Komunën tonë për shkak krijimit të krizës i shkaktuar nga pandemia COVID-19. I njoftoi edhe për mbështetjen e dhënë nga Komuna për disa familje në nevojë me gjera ushqimore dhe higjienike.

Nënkryetari i komunës z.Florim Bajrami – Përshëndetje për të gjithë. Kërkoj bashkëpunim nga të gjithë që ta kalojmë këtë situatë duke përmendur gjendjen e rënduar të komunitetit edhe

pse janë bërë kërkesa të vazhdueshme nëpër institucione dhe organizata të ndryshme kemi marrë vetëm përgjigjje verbale se së shpejti do të ju dalin në ndihme sadopak ta zbutin këtë gjendje të shkaktuar nga COVID-19. Njëherit Nënkryetari z.Bajrami bëri thirrje të vazhdueshme që të respektohen masat parandaluese, vendimet dhe rekomandimet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe u tha që ti përcjellin edhe në rrethin ku ata jetojnë.

z.Hesat Shatrolli – Përshëndetje për të gjithë. Unë si mjek i përgjithshëm apeloj tek ju dhe qytetarët që të respektohen të gjitha vendimet dhe rekomandimet e Ministrisë së Shëndetësisë pasi që gjendja në vend nuk është se është e mirë. Sugjeroi që të respektojmë në mënyrë të rreptë izolimin në shtëpi dhe të jemi sa më të kujdesshëm që ta kalojmë sa më mirë këtë gjendje pandemie.

znj.Mimoza Pajaziti - Përshëndetje për të gjithë. Nënkryetarë z.Bajrami kërkoi nga ana e juaj që të na e sigurojnë një listë për të gjitha familjet në gjendje të rëndë ekonomike që të mund ti ndihmojmë nga ato mjetet që do të ndahen nga Kuvendi i Komunës në mbështetje të luftës kundër pandemisë COVID-19.

znj.Fitore Lipovica - Përshëndetjeje për të gjithë. Kërkoi që ndarja e mjeteve për qytetarëve në nevoje, të jetë më transparente dhe mos të japin hapësira për keqpërdorime.

Pika: 5
Të ndryshme.

Kryesuesi i Komitetit për Komunitete z. Hajriz Haziri – Pasi nuk ka diskutime tjera e konsideroj mbledhjen e përfunduar.

Procesmbajtëse

Hatixhe Bungu-Qerimi

Kryetari i Komitetit për Komunitet

Hajriz Haziri

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KUVENDI I KOMUNËS - SKUPŠTINA OPŠTINE
FERIZAJ
UROŠEVAC